

-----

**BASHKIA TIRANË**

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “A & E Engineering” Shpk& “FM Ingegneria”

Adresa: Njesia Bashkiake nr.10, Rruga, Islam Alla, pallati IVEA 3/5

Procedura e prokurimit: Studim Projektim “Ndërtimi i Teatrit Kombëtar”, propozon të shpallet fitues:

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF 63974 – 07 – 02 -2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës, Qëllimi i kontratës është : Studim Projektim “Ndërtimi i Teatrit Kombëtar”

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike nr. 41 datë 06.07.2020

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit:

Faza e I-rë: Në sistemin e prokurimeve elektronike dt. 14.07.2020 ora 11.00

\* \* \*

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “A & E Enginering” shpk & “FM Ingegneria SPA”  
NIPTI K72113010E
2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Gjeokonsult & CO” shpk & “Archispace” shpk  
NIPTI K91810005U & L42403012A

Në fazën e parë nuk ka Operatorë ekonomikë të skualifikuar.

\* \* \*

Faza e II-të:

Hapja e propozimeve teknike, datë 13.08.2020, ora 11:00

Hapja e propozimeve ekonomike datë 10.09.2020, ora 11:00

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “A & E Enginering” shpk & “FM Ingegneria SPA”  
NIPTI K72113010E

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 60,300,000 (gjashtëdhjetë milion e treqind mijë ) lekë.  
Vlerësimi përfundimtar 96.2 pikë

2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Gjeokonsult & CO” shpk & “Archispace” shpk  
NIPTI K91810005U & L42403012A

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 55,635,000 (pesëdhjetë e pesë million e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë.

Vlerësimi përfundimtar 92.2 pikë

Nuk ka operatorë ekonomikë të skualifikuar.

\* \* \*

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 10.09.2020

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi, BOE“Gjeokonsult” & CO“shpk” & ”Archispace” shpk”, ka dorëzuar ankim pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, datë 28.08.2020, me nr.prot. 28493. Autoriteti Kontraktor ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 28493/1 datë 31.08.2020.

BOE“Gjeokonsult” & CO“shpk” & ”Archispace” shpk”, ka dorëzuar ankim pranë Komisionit të Prokurimit Publik, datë 14.09.2020. Me vendimin nr. 389/2020, datë 18.09.2020, Komisioni i Prokurimit Publik, ka vendosur:

1.Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Gjeokonsult & Co” sh.p.k. & “Archispace” sh.p.k.për procedurën e prokurimit “Shërbim Konsulencë”, me objekt“Studim-Projektim “Ndërtim i

Teatrit Kombëtar””, me nr. REF-63974-07-02-2020, me fond limit 60,317,899lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

2. Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomik “A & E Enginnering” shpk & “FM Ingegneria SPA” me nr.NIPTI K72113010E, me adresë: Njesia Bashkiake nr.10, Rruga, Islam Alla, pallati IVEA 3/5, se oferta e paraqitur nga ana juaj me një vlerë prej 60,300,000 (gjashtëdhjetë milion e treqind mijë ) lekë dhe e vlerësuar me 96.2 pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 49 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.